

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË (ERE) PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë, si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke konsideruar faktin që gjendja financiare në sistemin energjetik u karakterizua nga një performancë në rritje, veçanërisht në uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes dhe përmirësim të nivelit të likuiditetit në marrëdhëniet e kompanive të rregulluara (KESH sh. a., OST sh. a. dhe OSHEE sh. a.);

- Duke konsideruar si një aspekt shumë të rëndësishëm të punës së Entit Rregullator të Energjisë mbrojtjen e konsumatorëve;

- Duke pasur parasysh që legjislacioni i ri dhe reforma në sektorët e energjisë dhe gazit natyror kërkon një rregullator të fortë dhe plotësisht të pavarur, që do të ketë kompetenca të plota në rregullimin e sektorit të energjisë, në veçanti në dritën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike;

- Duke konsideruar që një liberalizim i mëtejshëm i tregut të energjisë elektrike garanton një siguri më të lartë furnizimi dhe një zhvillim më të mirë të tregut të energjisë elektrike;

- Duke njohur faktin që në vitin 2015 fillon implementimi i paketës së tretë të energjisë, e cila kërkon rregulla të reja në mënyrën e menaxhimit të tregut energjetik;

- Duke njohur shkallën e lartë të riskut hidrologjik për sistemin tonë energjetik, i cili bazohet vetëm në HEC-e;

Për vitin 2014:

- Vlerëson kontributin e ERE-s në hartimin e projektligjit për sektorin e energjisë elektrike, si dhe bashkëpunimin e saj me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse në këtë proces;

- Vlerëson punën e bërë nga ERE në drejtim të mbrojtjes konsumatorit, pavarësisht që mbetet akoma për të bërë në këtë drejtim;

- Vlerëson punën e bërë në monitorimet periodike ndaj operatorëve të licencuar në sektorin e energjisë elektrike, konkretisht në KESH sh. a., OST sh. a. dhe OSHEE sh. a., lidhur me transparencën në treg të operatorëve të energjisë elektrike, veçanërisht të OSHEE sh. a., si dhe monitorimet në veprimtarinë e import-eksportit dhe shkëmbimet e energjisë elektrike në KESH sh. a. dhe realizimin e investimeve në OST sh. a.;

- Vlerëson bashkëpunimin e ERE-s me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (Vjenë) për hartimin e projektligjit të gazit, i cili ka në themel aplikimin e paketës së tretë të energjisë;

- Vlerëson bashkëpunimin me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë, lidhur me projektin e TAP-it (*Trans-Adriatic Pipeline*);

- Vlerëson punën e bërë nga ERE për reflektimin direktivave të BE-se në projektligjin e ri të gazit, i cili pritet të miratohet;

- Vlerëson veprimtarinë e kryer në licencimin e subjekteve në veprimtaritë e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike;

- Vlerëson punën e bërë në miratimin e akteve të rëndësishme nënligjore për sektorin e energjisë elektrike dhe sektorit të gazit.

Kërkon që ERE për vitin 2015:

- Në kuadër të implementimit të paketës së tretë të energjisë, e cila kërkon rregulla të reja në mënyrën e menaxhimit të tregut energjetik, të marrë masat e nevojshme për miratimin e akteve nënligjore apo rregulloreve të nevojshme;

- Në kuadër të detyrave që lindin nga legjislacioni i ri i përmirësuar, si dhe sfidave të mëdha dhe me përgjegjësi në sektorët e energjisë dhe gazit natyror, të marrë masat e nevojshme për shtimin e kapaciteteve në strukturën e saj, si dhe forcimin e profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të stafit të entit;

- Të ushtrojë kompetencat e tij, me gjithë fuqinë që i jep ligji, për mbrojtjen e konsumatorit, veçanërisht në lidhje me problematikat e hasura me OSHEE-në, në mënyrë që konsumatori të mos ndihet i pambrojtur përballë operatorit, gjithashtu të rrisë përpjekjet për të bërë të mundur përmirësimin e zbatimit nga ana e OSHEE-së të detyrimeve të përcaktuara në Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, si dhe të vijojë të trajtojë me përgjegjshmëri ankesat e konsumatorëve që depozitohen pranë ERE-s;

- Në miratimin e planeve të investimeve të kompanisë OSHEE, të mbajë parasysh, nga njëra anë, mbrojtjen e konsumatorit dhe rritjen e transparencës ndaj tij dhe, nga ana tjetër, përmirësimin e treguesve, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe performancës së kompanisë;

- Të ushtrojë autoritetin e tij ndaj OSHEE-së, në mënyrë që në tremujorin e parë të vitit 2016 të mbyllet pajisja e konsumatorëve me matës, për t'i dhënë fund kështu faturimit aforfe;

- Të përmirësojë bashkëpunimin e saj me institucione të tjera, në veçanti me Autoritetin e Konkurrencës, duke bashkëpunuar praktikisht në garantimin e zbatimit të plotë të dispozitave të paketës së tretë të energjisë, e cila qartazi kërkon aktivitete të përbashkëta mes dy autoriteteve;

- Të kërkojë nga shoqëria OSHEE sh. a zbatimin e kuadrit ligjor për rritjen e transparencës në tregun e energjisë elektrike dhe të vazhdojë të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të vitit 2014 për shoqërinë;

- Me miratimin e projektligjit për sektorin e energjisë elektrike në Kuvend, të marrë masat e nevojshme për miratimin e akteve nënligjore apo rregulloreve të nevojshme, të cilat kërkohen në kuadër të zbatimit të tij;

- Me miratimin e projektligjit për sektorin e energjisë elektrike në Kuvend, ERE, si një institucion i pavarur dhe me një rëndësi kyçe, të sigurojë mbështetjen e një reforme të thellë në sektorin e energjisë elektrike, reformë e cila jo vetëm do të mund të zgjidhë një problematikë të krijuar ndërmjet operatorëve të ndryshëm në treg, por do të mundësonte zhvillimin më të shpejtë dhe të sigurt të një tregu efektiv dhe të qëndrueshëm në këtë sektor jetik për ekonominë e vendit;

- Të marrë masa për nxitjen e krijimit të një tregu të brendshëm dhe hapjen efektive të tregut për të gjithë klientët dhe furnizuesit, në veçanti në dritën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike;

- Të marrë masat për heqjen e barrierave që pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj në treg dhe të sigurojë një përfitim të klientëve prej funksionimit të efektshëm të tregut kombëtar;

- Të rrisë përpjekjet e tij në ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike, përmes përdorimit të mjeteve të komunikimit;

- Të vazhdojë bashkëpunimin me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë si në kuadër të projektit TAP, ashtu edhe për të përfituar nga eksperiencia e Rregullatorit Italian në sektorin e gazit natyror dhe sektorin e shpërndarjes;

- Të marrë masat e nevojshme për të nxitur përdorimin e energjisë së rinovueshme.

Miratuar në datën 21.5.2015

KRYETARI
Ilir Meta